

Në natën e e Lejletul-Kadrit çdo gjë dallohet dhe vendoset në vendin e vet

Kontribuar nga Administrator
Donnerstag, 01 August 2013

Dr. Mustafa Ceriq

Nata e Kadrit është momenti më i rëndësishëm në historinë e njerëzimit. Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj:

- sepse atë natë hapet qielli që Toka ta shohë ku e ka vendin

- sepse atë natë hapet lehvi mahfudhi që njeriu ta kuptojë kush është dhe çka është. Sepse melaqet dhe Xhibrili zbresin për çdo çështje. Sepse atë natë ndahet çdo gjë dhe vendoset në vendin e vet të vërtetë. Sepse atë natë ka filluar të shkruajë lapsi dhe të lexohet fjala. Për arsye se në natën e bekuar të Kadrit All-llahu (xh. sh.) e shpalli librin e përjetshëm Kur'anin në të cilin veçohet e pavërteta nga gënjeshtria, në të cilin përkrahet drejtësia e dënohet padrejtësia, në të cilin premtohet se do të triumfojë e mira, e do të jetë e dështuar keqja.

- A e dëgjon Toka zërin nga qielli i cili i thotë që nuk do të ishte ajo që është po të mos ishte qielli i stolitur me yllësi edhe Dielli me dritën e tij edhe Hëna që shkon pas tij edhe yjet që ndriçojnë në errësirë edhe malet të cilat sikur janë të palëvizshme, por ato lëvizin siç lëvizin retë dhe po të mos ishte deti në të cilin notojnë anijet si kodra edhe erërat të cilat mbarësojnë edhe shiu që gjelbëron, edhe nata që i shtrinë errësirat edhe dita që agon, nuk do të ishte Toka ajo që është.

- A e di Toka çfarë do të bëhet kur të çahet qielli dhe ta dëgjojë Zotin e vet dhe kur Dielli ta humbë shkëlqimin dhe kur Hëna të përgjysmohet dhe kur të bien yjet edhe malet të lëvizin dhe kur detet të mbushën me zjarr dhe të derdhët njëri mbi tjetrin, dhe kur Toka të zgjerohet dhe kur të dridhet me dridhjen më të fuqishme dhe kur ta nxjerrë barrën e vet dhe njeriu të thirr: Çfarë ka?!

Atë ditë, Toka lajmet e veta do t'i tregojë, sepse Zoti do ta urdhërojë.

- A e lexon njeriu në emër të Zotit të vet atë që i ka zbritur natën e Kadrit nga Lehvi Mahfudhi që ta mësojë se nuk do të ishte ai që është po të mos ishte krijuar nga gjaku i ngjizur (mpiksur), që nuk do të ishte ai që është, po të mos ishte krijuar nga lëngu që hidhet, i cili del mes shpinës (kurrizit) dhe kraharorit, që nuk do të ishte ai që është po të mos ishte krijuar nga përzierja e farës që të dëgjojë dhe shohë, që nuk do të ishte ai që është, po të mos ishte krijuar që të përpiqet, që nuk do të ishte ai që është, po të mos ishte krijuar në kohë të saktë dhe i drejtuar.

- A e ka mësuar njeriu që nuk është humbës (i dështuar) vetëm nëse beson dhe bën vepra të mira dhe nëse fletë drejtë dhe i porositë për këtë edhe të tjerët, dhe nëse është këmbëngulës në të mirën, por edhe të tjerët i porosit për këtë. A mendon njeriu se eshtrat e tij nuk do t'i tubohen? Gjithsesi, edhe shenjat në gishtin e tij tregues përsëri do të krijohen. A mendon ai se do të jetë i lirë të bëjë çfarë të dojë, se nuk do të përgjigjet? A nuk ka qenë pikë e farës që hidhet, pastaj gjak i mpiksur, të cilit All-llahu pastaj i caktoi madhësinë dhe ia bëri formën e harmonizuar dhe prej tij pastaj krijoi dy lloje mashkull dhe femër, dhe Ai, vallë, a nuk është në gjendje t'i ngjallë të vdekurit?!

- A mendon ai se askush atij s'mund t'i bëjë asgjë? A mendon se askush nuk e sheh? A nuk i ka dhënë All-llahu dy sy, gjuhën dhe dy buzë, dhe i shpjegoi edhe të mirën edhe të keqën? A mendon ai se pasuria e tij do ta bëjë të pavdekshëm?! A i beson njeriu asaj që i shpallet nga Zoti i vet – që të besojë në All-llahun, edhe melaqet e Tij, edhe librat e Tij, edhe Pejgamberet e Tij? A beson se nuk është mirësi që vetëm ta kthejë fytyrën e vet nga lindja dhe perëndimi.

- A beson, vërtet, që njeri i ndershëm (i mirë) është ai që beson në All-llahun dhe botën tjetër, edhe në melaqet, edhe në librat edhe në pejgamberet dhe i cili nga pasuria, edhe pse e do, u jep kushërirave të vet edhe jetimeve, edhe të varfërve, edhe udhëtarëve – mysafirë, edhe të pastrehëve, edhe për lirim nga robëria, dhe ai që e fal namazin dhe e jep zekatin, dhe që kur e merr një gjë obligim, e plotëson atë, dhe i ndershëm (i mirë) është në mënyrë të veçantë ai që është i durueshëm në skamje, edhe në sëmundje, edhe në fushë betejë.

Ky njeri mund të thotë se është besimtar i sinqertë.

- Ai e ka frikë All-llahun dhe largohet nga veprat e keqja. A e di njeriu që All-llahu dëshiron t'i a lehtësojë, për shkak se është krijuar qenie e pafuqishme, a e di njeriu që dëshiron të mallkojë dhe të bekojë, sepse është i ngutshëm, që dëshiron të debatojë më shumë se askush mbi atë që nuk e di. A e di njeriu se është krijuar për i ngutshëm, që është mendjelehtë dhe i padrejtë ndaj vetvetes, që është mosmirënjohës i hapët, kur e ndjen begatinë, ai gëzohet për të, e kur i ndodhë ndonjë fatkeqësi për shkak të asaj që ia kanë bërë duart e veta, atëherë njeriu nuk e pranon begatinë.

- A e di njeriu që e harron atë që duhet të mbajë mend? A di ta mbajë mend atë që nuk guxon ta harrojë? Ademi e harroi atë që duhej ta mbante mend. Nuk qe i vendosur. Prandaj i është thënë lapsit ta shkruajë fjalën që filloi të zbresë Natën e Kadrit në mënyrë që njeriu të mos ketë arsyetim që nuk e ka ditë, sepse e ka humbur fjalën.

Prandaj, Kur'ani është libër që lexohet në mënyrë që njeriu të mos thotë që nuk ka ditë, sepse e ka harruar fjalën.

- Prandaj Kur'ani është në gjuhën arabe që njeriu të mos ketë mundësi të thotë që e ka të paqartë fjalën. Prandaj, Kur'ani është libër që përkujton dhe i cili përkujtohet me lexim të vazhdueshëm, në mënyrë që njeriu të mos thotë që nuk e ka dëgjuar fjalën e Zotit. Për këtë arsye melaqet dhe Xhibrili zbresin që t'ia përkujtojnë atij që i bën dobi përkujtimi, e dobi i bën atij që e ka frikë All-llahun.

E nuk ka dobi prej tij ai që është më i keqi...

- Melaqet dhe Xhibrili sjellin përgjigje për çdo çështje të cilën duhet ta mësojë njeriu, mbi të cilën duhet mendojë drejtë, në të cilën duhet të besojë dhe të cilën duhet ta dije me siguri. Në natën e Kadrit që është më e mirë se njëmijë muaj, çdo gjëje i jepet kuptimi i vërtetë pikërisht sikur Pejgamberit të fundit Muahmmedit (s) atë natë në malin Hira All-llahu e caktoi që ëndrrat, sikur në agun e dritës, t'i dalin të qarta sikur Ylli i mëngjesit, ylli i ndritshëm.

- Për çfarë ka ëndërruar Muhammedi (s), sikur se thotë H. Aishja, pasi ishte tërhequr në vetmi të devotshme në malin Hira: që të pret përgjigjet në pyetjen kush është njeriu, prej nga është njeriu dhe ku shkon ai njeri? Ëndërronte Muhammedi (s) për botën në të cilën njeriu nuk do të jetë i humbur, i harruar, i mposhtur dhe i nënçmuar. Muhammedi (s) ëndërronte për një botë në të cilën jetojnë njerëz të cilët janë krijuar prej një gruaje dhe një burri, prej të cilëve kanë lindur popuj dhe fise që të njihen dhe të pranohen mes vete dhe midis të cilëve më i miri është ai i cili më shumë e ka frikë Zotin. Ëndërronte Muhammedi (s) për një botë në të cilën njerëzit do ta përkrahin të mirën, e do ta dënojnë të keqën.

- Ëndrrat e tij janë njëmendësuar, sepse ummeti i tij u dëshmuua si më i miri në histori pikërisht për shkak se promovoi të mirën dhe e luftoi të keqën në botë.

Përktheu: Mr. Muhidin Ahmeti